



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2022

Procesverbal
Nr 13, datë 28.10.2022.

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në pallatin e kulturës
“Labëria “. (Ora 10²⁰)

Marrin pjesë:

- | | |
|----------------------|----------------------|
| 1.Jonela Halili | 14.Grigor Dede |
| 2.Ina Islamaj | 15.Ardian Skëndaj |
| 3.Simo Petromilo | 16.Arben Meksi |
| 4.Brunilda Cani | 17.Edlira Kapllanaj |
| 5.Anisa Shametaj | 18.Frosina Qyrdeti |
| 6.Ramona Jaho | 19.Asime Feraj |
| 7.Migena Balla | 20.Briseida Çakërri |
| 8.Brunilda Saliuj | 21.Julian Bleta |
| 9.Sokol Kushta | 22.Gentian Hamzaraj |
| 10.Kasëm Mahmuti | 23.Edison Kapaj |
| 11.Pëllumb Nezha | 24.Rozina Kormuzi |
| 12.Anxhela Aliraj | 25.Lindrit Beqiraj |
| 13.Englantina Imeraj | 26.Kreshnik Tepelena |

Mungojnë :

- 1.Alboren Aliaj
- 2.Ervis Moçka
- 3.Ervis Caushaj
- 4.Sulltana Bilbili
- 5.Istref Dobi

- 6.Klara Bajaziti
- 7.Elona Toçaj
- 8.Rudi Pashaj
- 9.Roneda Muçaj
- 10.Andi Resulaj
- 11.Sulejmën Bubeqi
- 12.Kristaq Meçi
- 13.Liljana Breshani
- 14.Klearda Rapushi
- 15.Teki Xhemalaj
- 16.Mujo Shakaj
- 17.Adiola Gjoka
- 18.Jerina Dervishaj
- 19.Paula Sullaj
- 20.Evis Allushi
- 21.Besian Gega
- 22.Fatos Rukaj
- 23.Bujar Osmanaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
KËSHILLI BASHKIAK

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2022

Procesverbal
Nr 13/1, datë 28.10.2022.

Znj.Migena Balla – Përshëndetje të gjithëve !

Para se të fillojmë mbledhjen , doja të theksoja se në sajë të një bashkëpunimi me Drejtorinë e BE, në lidhje me sensibilizimin për nismën në kuadër të Tetorit rozë , në lidhje me kujdesin që duhet të tregojnë gratë për shëndetin e tyre , fjalën e ka zonja Fabiola.

Znj.Fabiola Deliaj/Drejtores BE- Ndihem e nderuar që jam sot këtu , për të përcjellë mesazhin për nismën , fushatë sensibilizuese për tetorin rozë. Në lidhje me kujdesin që duhet të tregojnë femrat, nënat, gratë, i cili është primar. Ju jam mirënjohëse që po përcillni këtë nismë me këtë mesazh. Jam falënderuese për këtë aktivitet modest .

Znj.Jonela Halili – Referon në lidhje me këtë nismë, sensibilizimin për muajin tetor, tetorin rozë dhe që nuk mjafton vetëm ky muaj, për kujdesin për jetën.

Znj.Ina Islamaj – Dhe në emër të Kryetares së Komisionit Shëndetësor, në lidhje me këtë mesazh , me këtë nismë për të treguar kujdes më të madh për shëndetin e grave dhe vajzave. Strukturat shëndetësore, janë aty për tju ardhur në ndihmë. Ju lutem, ti kushtojmë kohë shëndetit, jetës tonë. Faleminderit.

Znj.Migena Balla - Nëqoftëse, keni ndonjë gjë tjetër, ndonjë mesazh ? Edhe njëherë faleminderit Drejtores së BE dhe grave e zonjave këshilltare , asnjëherë nuk është shumë për tu kujdesur për shëndetin tuaj.

Vazhdojmë mbledhjen. Para se të fillojmë , fjalën e ka zonja Jonela , për të na njohur me shprehjen e ligjshmërisë.

Znj.Jonela Halili - Me shkresën e ardhur nga institucioni i prefektit të qarkut , vendimet e këshillit të mbledhjes së kaluar Nr 69,70,71,72,73,74,75,76 dhe77, janë shpallur të ligjshëm.

Znj.Migena Balla – Atëherë, në lidhje me rendin e ditës, janë 5 pika . U reflektua dhe dje në komisione për pikën 4 të rendit të ditës , për ndryshimin, ishte “ Për disa shtesa dhe ndryshime....” të bëhet “Për një ndryshim në VKB Nr 78

Pra, hedhim për miratim, votojmë rendin e ditës.

Pro – 26 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 1 të rendit të ditës, në Miratimin e Procesverbalit të mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 30.09.2022. Jeni njohur me materialin, me e-mail. Keni ndonjë gjë ?

–Jo.

Atëherë kalojmë në votim. Votohet.

Pro – 26 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2022

Procesverbal
Nr 13/2, datë 28.10.2022.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë për muajin shtator 2022”.

Nga administrata?

Znj.Irena Stasa – Përshëndetje!. Për muajin shtator , përfitojnë ndihmë ekonomike nga të ardhurat e bashkisë, 42 familje, verifikuar këto nga administratoret e qytetit dhe të njësive.

Bashkia Vlorë – 31 familje.

Njësia Qendër – 5 familje.

Njësia Orikum – 1 familje.

Njësia Novoselë – 2 familje.

Njësia Shushicë – 3 familje.

Pra, 42 familje përfitojnë ndihmë ekonomike dhe futen 7 familje të reja, pasqyruar në relacion.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

-Jo.

Kalojmë në votim.

Pro – 26 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2022

Procesverbal
Nr 13/3, datë 28.10.2022.

Znj.Migena Balla - Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin shtator 2022”.

Një relacion nga administrata ?

Znj.Irena Stasa - Me ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar , trajtohen 17 familje , me fondin e qeverisë, të dala këto nga skema dixhitale.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

-Jo.

Kalojmë në votim.

Pro – 26 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2022

Procesverbal
Nr 13/4, datë 28.10.2022.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës, në miratimin e projekt vendimit “ Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 78, datë 02.12.2021 “Për miratimin e numrit të punonjësve të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2022”. (Për administratën e bashkisë dhe institucionet e varësisë).

Nga administrata një relacion .

Znj.Laura Brinja – Struktura e Bashkisë Vlorë, ka kaluar në muajin dhjetor 2021. Në muajin shtator 2022, ka dalë një VKM, Nr 625, ku bëhen ndryshime në rritje pagash për punonjësit, ndryshime reference masteri dhe reference vjetërsie , ishte 30 mijë dhe bëhet 34 mijë si, dhe ndryshime të tjera që ka bërë VKM , janë 7% .

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime?

U diskutua gjatë dhe në konferencën e kryetarëve dhe komisionin e financës.

Z.Ardian Skëndaj - Kam kërkuar organigramën dhe strukturën .

Znj.Migena Balla – E kemi kaluar strukturën .

Z.Daut Zëraj – Ky projekt vendim , nuk ka lidhje me asnjë punonjës të bashkisë . Struktura, është miratuar në muajin dhjetor 2021, me numër punonjësish. Ky është një ndryshim për funksionin, për pozicionin, ndryshim në këtë zë të pagave, pa bërë ndryshime në buxhet, sikurse e theksuam në raportin përfundimtar. Pra, është thjesht , zbatim i VKM.

Znj.Migena Balla – Është kërkesë e vazhdueshme , të na i vini në dispozicion strukturën.

Z.Ardian Skëndaj – S’ka pse përgjigjet vetëm zoti Daut .

Znj.Migena Balla – Para se të kalojmë për miratim strukturën për vitin e ardhshëm..

Z.Kasëm Mahmuti – Efekti financiar..Sa lekë do të ketë shtesë shpenzimi, për këtë 3-mujor, ose 4-mujor ose dhe vjetor. Do ta doja për referencë . Rrisim pagat, por të shohim dhe shpenzimet e tjera .

Z.Daut Zëraj – Efekti për buxhetin e vitit 2022, është për 3 muaj, (shtator – tetor – nëntor) rreth 9.6 miljonë lekë të reja...,për këto 3 muaj.

Znj.Migena Balla – Kërkoj dhe për vjetorin ..

Z.Daut Zëraj - Kur të bëjmë buxhetin e viti 2023, do ta pasqyrojmë.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

-Jo.

Kalojmë në votim.

Pro -

Kundër -

Abstenim – 1 votë. (z.A.Skëndaj)

(Ndërpritet mbledhja . Rifillon në orën 10⁵⁵)

Znj.Migena Balla – Atëherë, fjalën e ka kryetari i grupit, zoti Skëndaj .

Z.Ardian Skëndaj – Votën pro, do ta jap për ata punonjës të bazës, që kanë nevojë.

Znj.Migena Balla – E hedhim dhe njëherë në votim.

Pro – 26 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr _____ Prot

Vlorë, më ____ . ____ 2022

Procesverbal
Nr 13/5, datë 28.10.2022.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës, në pikën “Të ndryshme “.

Z.Grigor Dede – Jemi të gjithë qytetarë të Vlorës. Duhet të punojmë dhe tu shërbejmë qytetarëve. Kam kërkuar, kam bërë disa herë kërkesa dhe , nuk kam marrë asnjë përgjigje, vetëm ndonjë me copi past. Kam shumë kërkesa , ankesa nga qytetarët, nuk marrin asnjë përgjigje. Keni detyrim ti dëgjoni dhe tu shërbeni qytetarëve. Sa miratuar rritjen e rrogës së administratës, por një pjesë e madhe e tyre nuk bëjnë punën, nuk u shërbejnë qytetarëve. Do ti drejtohem tani drejtorive përkatëse , për punonjës përkatës.

Z.Gentian Hamzaraj – Kam një kërkesë për buxhetin e vitit 2022, fondi në lidhje me rrugën e Kërkovës. Faleminderit që ka filluar kjo rrugë , por doja të thosha që i gjithë ky fond, le të hidhet në Njësinë Administrative Qendër .

Z.Daut Zëraj – Pjesa që ngelet, nuk mund të prokurohet, është mbyllur afati. Do të shihet vitin tjetër rruga e Bestrovës...Jo 100% investimet , pasi nuk janë dhe të ardhurat 100%. Janë lekë në administrim, jo në bankë. Do shihet rruga e Bestrovës.

Z.Sokol Kushta – Edhe unë nuk kam marrë asnjë përgjigje për problematikat që kam ngritur. Disa biznese të mëdha që punësojnë shumë punonjës , po vënë në punë panelet.. Ka një VKM për lehtësimin e tyre. Hasin pengesa me muaj. Pyetje për urbanistikën, për Dautin, me VKM. Kam dhe një vërrejtje për median . Duhet të jetë gjithpërfshirëse.

Kam folur për pastrimin, as nga firma dhe as nga bashkia nuk ka folur njeri. Unë do të flas për problemet . Çështja e bizneseve të mëdha , është akute. Ndihma për ato panele, të lehtësohen..Sa është afati ligjor, për këto biznese pasi kanë bërë kërkesën , kur do fillojnë nga puna . Kanë VKM, paguajnë taksat ..

Z.Daut Zëraj – Konkretisht, nuk ka lidhje me financat. Do evidentohen dhe do të kthehet përgjigje.

Z.Ardian Skëndaj – Një shqetësim, në lidhje me ato apartamentet, 75 apartamente që i rikthyem. Çfarë bëhet, se familjet kanë nevojë të përfitojnë, janë familje në nevojë. Pse është kjo heshtje ..Ta kërkojmë të gjithë.

Znj.Migena Balla – EKB do ti nxjerrë në ankand.

Z.Ardian Skëndaj - Ne nuk kemi kthyer asgjë. I kthjem për tu riparë listat. Ajo listë ishte bërë me njerëz që nuk meritonin të ishin në listë.

Znj.Migena Balla - Edhe ne na ka ardhur shkresë nga EKB.

Z.Ardian Skëndaj - Ta marrin ata që e meritojnë .

Znj.Migena Balla – Komisioni mendon se, personat që ishin në listë , përmbushin kriteret, sipas ligjit.

Z.Ardian Skëndaj – Jeni që këto apartamente, të venë atje ku duhen ?

Znj.Migena Balla – Po. Asnjë s’është për pazar.

Z.Ardian Skëndaj – Çfarë hapsire ligjore ka që administrata e bashkisë me këshillin ti ndajnë ato apartamente ?

Znj.Migena Balla – Enti kombëtar i banesave , është pronar.Është Enti që i ndërton ato, ka një marrëveshje me bashkinë.

Z.Ardian Skëndaj – Ata që bredhin me mmakina të mira dhe të përfitojnë banesë, po kjo nuk shkon.

Z.Sokol Kushta – Lista ka emra.

Z.Ardian Skëndaj - Ne thamë korrigjoni emrat.

Znj.Migena Balla – Aplikimet u shtynë.

Znj.Jonela Halili – Nëqoftëse, ka nevojë, çfarë mund të bëjmë ne si këshill, një kërkesë..., ku ka mbetur ,...çfarë duhet, na thoni që mos ti lëmë kështu.

Z.Daut Zëraj – Është marrë Drejtoria e Infrastrukturës. Do kontaktoj me ata dhe ju, por jashtë kriterëve dhe jashtë vendimeve të këshillit, nuk mund të marrë asnjë. Ishte një informacion jo zyrtar në lidhje me ndarjen e këtyre apartamenteve ..., për Transballkaniken.

Z.Ardian Skëndaj - Mbledhjen e kaluar, miratuam shtesë orarësh , për linjën e Novoselës. Ky shtim orarësh, bëhet për qëllime të tjera. Dua oraret, informacion ku niset, kur niset...E kërkonte çdo 30 minuta, e bëme çdo 1 orë. Na u tha, për nevoja të komunitetit, por përdoret për nevoja të tjera.

Znj.Migena Balla – Ishte kërkesë dhe nga Shoqëria Civile.

Z.Ardian Skëndaj – Pra, itinerari. Oraret, kur niset, vendi.Bëhen abuzime në emër të komunitetit. -Tabelat e reklamave të kazinove..Ka 2 muaj që ata s’paguajnë taksa. Diçka luhet aty. Ttaimet e kishin 1 muaj...Kush i merr lekët? Këto duhet të na shqetësojnë , ku shkojnë paratë e qytetarëve. Janë probleme që më shqetësojnë mua. Zyrtarisht këto taksa nuk shkojnë në tatime. Dua të jemi bashkë për zgjidhjen e problemeve. Bashkia s’jep zgjidhje.

Znj.Migena Balla – Për shqetësimet, jemi të gjithë bashkë.

Z.Ardian Skëndaj – Kryesorja për mua është ndarja e apartamenteve.

Znj.Migena Balla – Nuk paragjykojmë dot. Nuk e kemi një listë, nuk flasim dot. Një herë na erdhi, e kthjem, tani duhet të presim ...

Z.Ardian Skëndaj – Rruga tek ish-Shtëpia e Oficerëve, është shumë problem, është një kaos atje në oraret e mëngjesit dhe të drekës, qëndrojnë furgonat...Ne si këshill duhet të marrim ndonjë masë, për të gjitha këto që nuk zgjidhen... Nuk gjejnë zgjidhje bizneset, qytetarët..Drejtoria e Urbanistikës , është inekzistente. Asnjë projekt për shkollat.

Znj.Brunilda Saliaj – Kisha 2 probleme shumë konkrete.

1-Linja Çole – Spital, kjo linjë ishte çdo gjysëm ore. Kisha kërkesë për kompaninë, të kthehej në këto orare, të paktën në mëngjes, deri në orën 09.00

2-Ambientet përreth shkollave “Jani Minga “ dhe “Ismail Qemali “ , ka kosha të tejmbushur me mbeturina. Këto shkolla frekuentohen dhe nga fëmijët e kopshteve. Përreth këtyre koshave, nëqoftëse, s’mund të pastrohen, mund të ngrihet ndonjë mur izolues, janë mbetjet shumë keq, sidomos tek shkolla “Ismail Qemali “

Z.Edison Kapaj – Doja informacion në lidhje me Rrugën Vlorë – Fier. Doja nga supervizori i kësaj rruge , për një interpretim të këtij aksi rrugor, ku ka pasur aksidente të shumta. Nëqoftëse, ka mundësi ndonjë informacion nga firma. Falënderoj Autoritetin Rrugor Shqiptar për këtë investim.

Z.Pëllumb Nezha - Në lagjen e Pus Mezinit , problem uji i pijshëm, ka zënie rruge... E kërkojnë zyrtarisht banorët, e kanë sjellë kërkesën në bashki .

-Investimi që është bërë për ujrat e zeza, 30% nuk janë bërë, vazhdojnë me gropa septike ..Kush e ka këtë , Ujësjetlësi ?

Znj.Edlira Kapllanaj – Shqetësim për bllokun tek “Conad”-i, ka të dhëna që ka familje që mbajnë kafshë në shtëpi . Për post prishjes së qetësisë, por dhe banesat po mbartin mikrobe. Nga Policia bashkiake, një informacion. A ka ndonjë kërkesë nga banorë apo kryetarë rajonesh për këtë problem ? A funksionojnë gjobat ? Janë shqetësim shumë i madh. I lutem Policisë bashkiake të merret me këtë problem, është shumë shqetësim.

Z.Kasëm Mahmuti - Në lidhje me problemin që ngriti Edisoni, edhe unë mendoj , ta ftojme në këshill për një informacion përfaqësues të firmës....Zakonisht ka problematika në lidhje me projektet , nga qytetarët. Duke ardhur përfaqësuesi i firmës , projektin, ballafaqohemi me kërkesat e qytetarëve. Kanë ndodhur shumë aksidente . Aksi do të rehabilitohet. Është një detaj që thjesht ta specifikojmë. Pra, të bëhej ftesë për firmën dhe në prani të qytetarëve , për të bërë ndonjë ndryshim për të përmirësuar .

Ndërsa në lidhje me itinerarin e mjeteve të njësisë Novoselë, nëqoftëse, abuzohet, numrat e telefonit i kanë në dispozicion qytetarët, sepse flitet në emër të tyre , prandaj tu bëhet shërbimi.

Z.Ardian Skëndaj – Një shqetësim nga banorët e fshatit Babicë e Vogël, nuk ka kuzanë plehrash. Taksat i paguajnë, pse mos tu përgjigjen. Kam kërkuar kontratën e pastrimit, të shohim si zbatohet.

Z.Ardi Peçuli /Drejtoria e Veterinarisë – Për një ndryshim në VKB Nr 80 ...(lexon)...përgjigje kërkesës së zonjës Liljana Breshani. Nuk ka ligj , që personi mos të mbajë kafshë në shtëpi , as për numrin.

Znj.Migena Balla – Do shohim si do funksionojnë gjobat.

Znj.Jonela Halili – Kam bërë disa takime me nëna të fëmijëve të kopshteve dhe shkollave dhe, dua një informacion. Lidhur me disa kërkesa, shqetësime të tyre , kam nisur me e-mail një kërkesë në datën 17 tetor .

-Gjatë verës, nuk funksionojnë kopshtet ?

-mjetet mësimore...

-mosrregjistrim i fëmijëve etj... Dua të di kur do ta kem një përgjigje ?

Znj.Laura Brinja – Kam një draft, jo zyrtar, po ju'a nis me e-mail.

Znj.Asime Feraj – Vlora është qytet i bukur. Një pjesë e Rajonit Nr 1 nuk e ndjen veten si të tillë. Do ti kërkoja bashkisë një fond për ndërhyrjen në infrastrukturë, për këtë rajon, por me emërtime rrugësh konkrete , meqenëse jemi para hartimit të buxhetit.

Znj.Migena Balla - Nëqoftëse nuk keni gjë, diskutim tjetër, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit.

Mbajti Procesverbalin
Zhaneta Gjika